

VIDEO/ Dy apartamente me qera i ktheu në bazë armatimesh, kush është 25-vjeçari që u arrestua së bashku me partneren (EMRAT)

13 Korrik, 2022 15:05



Tiranë - Finalizohet operacioni policor i koduar "Ruger"

Madhësia e tekstit: - +

Policia e Tiranës ka zbuluar dy baza të vërteta armësh në kryeqytet, teksa ka arrestuar dy të rinj që i posedonin ato. Në pranga kanë përfunduar 25 vjeçari Kristjan Gjini dhe shoqëruesen e tij 22 vjeçe, Françeska Kolgjegia.

Ata janë ndaluar në kuadër të operacionit policor të koduar “Ruger”, ndërsa fillimisht kanë rënë në sy të efektivëve të repartit “Shqiponja”, pasi 25-vjeçari dhe partnerja ishin duke lëvizur me makinë në bulevardin “Gjergj Fishta”, me Gjinin që mbante me vete një armë zjarri.

Më pas policia zbuloi se Kristijan Gjini kishte marrë me qera dy ambiente në një kompleks rezidencial në kryeqytet. Një prej tyre ishte banesa ku ai jetonte, ndërsa apartamenti tjetër përdorej nga vajza e arrestuar.

Policia zbuloi në të dy apartamentet arsenalin ushtrak që përbëhej nga: 7 armë zjarri, 4 silenciatorë, municion luftarak, krehra, lëndë e dyshuar narkotike, 2 radio si ato të Policisë, dorashka, 7 maska, një thikë, dokumente të dyshuara të falsifikuara, targa të huaja dhe 2 automjete.

NJOFTIMI I POLICISE:

Finalizohet operacioni policor i koduar “Ruger”. Operacioni, i zhvilluar nga Sektori kundër Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 2 dhe Forcën e Posaçme “Shqiponja”.

Sekuestrohen 7 armë zjarri, 4 silenciatorë, municion luftarak, krehra, lëndë e dyshuar narkotike, 2 radio si ato të Policisë, dorashka, 7 maska, një thikë, dokumente të dyshuara të falsifikuara, targa të huaja dhe 2 automjete.

Vihen në pranga 2 shtetasit që mbanin armët dhe sendet e tjera të paligjshme, në ambientet e banesave të tyre.

Specialistët e Sektorit kundër Krimeve të Rënda ndaj Jetës dhe Pronës në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Nr. 2 dhe Forcën e Posaçme “Shqiponja”, në bazë të informacioneve të marra në rrugë operative, kanë organizuar dhe finalizuar me sukses operacionin policor të koduar “Ruger”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:

– K. Gj., 25 vjeç dhe F. K., 22 vjeçe, aktualisht banues me qira, në Tiranë.

Shërbimet e Policisë, në bulevardin “Gjergj Fishta”, kanë ndaluar automjetin me drejtues shtetasin K. Gj., të cilit gjatë kontrollit fizik, iu gjet dhe sekuestrua, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri pistoletë.

Në vijim të veprimeve, gjatë kontrollit të ushtruar në 2 banesa të ndryshme, të marra me qira nga ky shtetas (në njërën prej të cilave jetonte shtetasja F. K.), shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, 4 armë zjarri pistoletë, 2 armë zjarri automatike, 4 silenciatorë, 7 maska, 2 radio si ato të Policisë, një thikë, sasi lëndë të dyshuar narkotike cannabis sativa, fishekë të kalibrave të ndryshëm, dorashka, krehra, dokumente të dyshuara të flasifikuara, targa të huaja dhe 2 automjetet që përdornin shtetasit e arrestuar.

Po punohet për identifikimin dhe kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë veprimtari kriminale.


Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: ARSENAL ARMESH policia e tiranes

TË NGJASHME



21 Qershor, 2022


Jo vetëm armë, por edhe tritol, shënjestra optike për armët e precizionit e paruke, policia detaje për operacionin "Heshtja 2" (Video)



Të fshehura në një garazh/ Detaje nga operacioni me 1 të arrestuar në Tiranë, ja sa armë zjarri u gjetën

21 Qershor, 2022

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




14 Korrik, 2022

Denoncimi në Polici, nipii deputetit të PS godet me grushte kryebashkiakun e Divjakës. Zbulohet arsyeja




14 Korrik, 2022

Raporti për 2021-shin/ Kryeprokurori Olsian Çela: Prioritet lufta kundër pastrimit të parave, janë rritur rastet e hetuara për korrupsion



14 Korrik, 2022

"Situata nuk përbën rrezik as për banorët as për pushuesit", zjarri në malin e Çikës, prefekti i Vlorës: Pritet ndërhyrja nga ajri, s'i fusin dot njerëzit, është zonë e thepisur



14 Korrik, 2022

Lajmi për arrestimin e dhëndrit për fabrikë droge, reason për "BalkanWeb" kryebashkiaku i Pogradecit



14 Korrik, 2022


Zbulohet fabrika e drogës në Ohër, mediat maqedonase: Arrestohet dhëndri i kryebashkiakut të PS



14 Korrik, 2022


Gjendet e pajetë në banesën e saj në Elbasan një e moshuar, çfarë dyshon policia

KATEGORIA VIDEO



14 Korrik, 2022

"Janë blerë të brendshme dhe është shitur beton. Do dalin skandale për...", ish-drejtoresha e Tatimeve: Gindra mln euro të marra me skema evazionit. Pagaunë dadon filipineze të Stela Gugalljas



Klodiana Lala | 14 Korrik, 2022

Rikthimi i frikshëm i dosjes "Tropa". Kush e vrau kushëririn e Fatmir Haklajt ditën e 22-vjetorit të ekzekutimit të të afërme të bosit të drogës




13 Korrik, 2022

VIDEO/ Flakë gjigante që i afrohen fshatit, shihni se çfarë po ndodh në Dhërimi




13 Korrik, 2022

Afera e inceneratorëve/ "Pse nuk flitet për grup të strukturuar kriminal?", gazetari: Komedie e zezë. Shkon në SPAK ajo e kazaneve



13 Korrik, 2022

FOTO•VIDEO/ Prej tre ditësh aktiv, avancon zjarri në malin e Çikës në Dhërimi. Largohen pushuesit



13 Korrik, 2022

Zjarr masiv në Fushë-Krujë pranë fabrikës së çimentos. Dyshimet e para (VIDEO)